

PETROL-OIL-BALLKAN Sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 12

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Aktive afatshkurtra			
Të tjera llogari të arkëtueshme	4	727,980	-
Total aktive afatshkurtra		727,980	-
Aktivët afatgjatë		-	
Kapitali nënshkruar i papaguar	5	2,625,000	-
Total aktive afatgjatë		2,625,000	-
Total aktive		3,352,980	-
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	6	88,957	-
Detyrime tatimore	7	8,370	-
Të tjera detyrime	8	32,544	-
Total detyrime afatshkurtra		129,871	-
Totali i detyrimeve		129,871	-
KAPITALI			
Kapitali nënshkruar		3,500,000	-
Fitimi i ushtrimit		(276,891)	-
Total kapitali	9	3,223,109	-
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		3,352,980	-

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 12, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	10	849	-
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera		(176,455)	-
Lënda e parë dhe materiale të			
1) konsumueshme		-	-
2) Të tjera shpenzime	11	(176,455)	-
Shpenzime të personelit	12	(54,024)	-
1) Paga dhe shpërblime		(21,687)	-
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërorë/shëndetësore		(32,337)	-
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	13	(24,971)	-
Shpenzime financiare	14	(22,290)	-
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime të</i>			
1) <i>ngjashme</i>		-	-
2) <i>Shpenzime të tjera financiare</i>		(22,290)	-
Fitimi/humbja para tatimit		(276,891)	-
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
Fitimi/humbja e vitit	15	(276,891)	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		(276,891)	-

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 12, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PETROL-OIL-BALLKAN Sh.a.

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Kapitali aksionar	Fitimi/(humbja) e ushtimit	Total
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014	-	-	-
Fitimi / Humbja e vitit		(276,891)	(276,891)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:		-	-
Transferimi në rezultatit e mbartur		-	-
Emetimi i kapitalit aksionar	3,500,000	-	3,500,000
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	3,500,000	(276,891)	3,223,109

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 12, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i Petrol-Oil-Ballkan Sh.a. më 31/03/2016 dhe janë firmosur si më poshtë:



Udhëzues Mazars

Mazars shp.k. Emin Duraku "Pasi-Bijakët"
No.5, 1000, Tiranë, Albania
Hartues i Pasqyrave: 06 42727180 ES
www.mazars.al info@mazars.al

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	(276,891)	-
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Diferenca këmbimi jo nga aktivitete operative	849	-
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	147,020	-
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(745,978)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(875,000)	-
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Emetimi i kapitalit aksionar	875,000	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	875,000	-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	-	-
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	-	-

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 12, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

"Petrol-Oil-Ballkan sh.a." është themeluar si një shoqëri aksionare me 17.06.2015 e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) me Kapital Fillestar prej 3,500,000 Lek. Kompania është një person juridik që vepron sipas ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë tregtare".

Shoqëria është e regjistruar në degën e tatim-taksave me NIPT L51817007A. Selia e Shoqërisë ndodhet në Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, Tiranë, Shqipëri.

Aksioneri i vetëm i shoqërisë është z. Blerim Hoxha.

Objekti i aktivitetit të kompanisë është nxjerrje, shfrytezim, perpunim, import-eksport, shitje me shumice dhe tregtim i hidrokarbureve, si benzine, naftë, gas, LPG (gaz i lengshëm) CNG (gaz natural i kompresuar), bitum, lubrifikante si edhe të gjithë produktet e tjera të lidhura dhe nen-produktet e tyre dhe të gjitha aktivitetet e lidhura apo sekondare të aktiviteteve të lartpërmendura.

Më 31 dhjetor 2015 Shoqëria kishte 1 punonjës. Më 31 dhjetor 2014 Shoqëria nuk kishte asnjë punonjës pasi është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) më 17.06.2015.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.6. Krahaseshmëria e informacionit kontabël**

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/LEK	137.28	140.14

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në bankë. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

3.3. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.4. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.5. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.6. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15%.

3.7. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

4. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme përbëhen nga e drejta e TVSH-së për t'u arkëtuar dhe debitorë të tjerë.

Ky zë më 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2015
TVSH për t'u arkëtuar	24,970
Debitorë të tjerë	703,010
	727,980

5. Kapital i nënshkruar i papaguar

Kapitali i nënshkruar i papaguar më 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2015
Kapital i nënshkruar i papaguar	2,625,000
	2,625,000

6. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015
Furnitorë	88,957
	88,957

7. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2015
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	8,370
	8,370

8. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2015
Të tjera detyrime	32,544
	32,544

9. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i shoqërise është 3,500,000 LEK i zotëruar 100% nga aksionari i vetëm Blerim Hoxha.

	31 dhjetor 2015
Numri i aksioneve	100
Vlera nominale (në LEK)	35,000
Kapitali i nënshkruar	3,500,000

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 3,500,000 LEK, nga të cilat kapitali i shlyer pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit është në shumën prej 875,000 LEK.

10. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitimet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhurat nga këmbimet valutore për marrëdhëniet tregtare	849
	849

11. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015
Shërbime kontabiliteti	124,852
Taksa dhe tarifa vendore	49,703
Shpenzime te tjera	1,900
	176,455

12. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime page	21,687
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	32,337
	54,024

Numri i punonjesve më 31 dhjetor 2015 është 1.

Shpenzimet e personelit deklaruar në Drejtorinë e Tatimeve janë 193,636 Lekë. Mospërputhja në shumën 171,949 Lekë vjen si rezultat i shpenzimit të pagës bruto, për administratorin e cila llogaritet vetëm për efekt sigurimesh.

13. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Penalitete	24,971
	24,971

14. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Fitim nga kursi i këmbimit nga aktiviteti financiar	809
Humbje nga kursi i këmbimit nga aktiviteti financiar	(23,099)
	(22,290)

15. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Humbja para tatimit	(276,891)
Gjoha dhe penalitete	24,971
Humbja para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(251,920)
Humbja fiskale	-
Tatim fitimi 15%	-
Humbja Neto	(276,891)

16. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.